

Mundësi për aplikim të Bashkive në thirrjen e CEI Cooperation Fund 2025

Synimi i Thirrjes:

Qëllimi është të mbështeten iniciativa dhe projekte me ndikim afatmesëm dhe afatgjatë, të cilat kontribuojnë në objektivat specifike të Planit të Veprimit të CEI dhe që forcojnë përfshirjen institucionale dhe shoqërore në rajon.

Aktivitetet duhet të adresojnë një ose më shumë nga këto prioritetet:

- Pasojat e agresionit ushtarak rus kundër Ukrainës
- Qeverisja e mirë dhe zhvillimi institucional
- Fuqizimi i të rinjve, grave dhe grupeve vulnerabël
- Përmirësimi i shëndetësisë
- Lidhja rajonale dhe mobiliteti i qëndrueshëm
- Energjia e rinovueshme, efienca dhe siguria energjetike

Aktivitetet e pranueshme përfshijnë trajnime praktike, shkëmbime personeli, vizita studimore, misione peer review, ndihmë në përgatitjen e planeve strategjike, transferim teknologjie dhe ndihmë teknike për ngritje kapacitetesh.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Thirrja ndahet në dy segmente:

- Segmenti 2.1: CEI Thematic Agenda – përfshin temat përparësore të CEI, si: transport dhe lidhje, mjedisi dhe energjia, zhvillimi i qëndrueshëm, shoqëria dixhitale, inovacioni, shëndetësia, arsimi, qeverisja e mirë dhe zhvillimi ekonomik.
- Segmenti 2.2: Focused Section – një seksion i fokusuar në përmbajtje tematike të përcaktuara nga Sekretariati CEI në përputhje me prioritetet aktuale.

Rezultatet e pritshme:

- Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar.
- Nxitja e integritetit evropian të vendeve jo-anëtare të BE-së brenda CEI.
- Transferimi i njohurive, shkëmbimi i përvojës dhe ngritja e kapaciteteve.
- Organizimi i eventeve të profilit të lartë si CEI Flagship Events që shërbejnë si platforma dialogu.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

- Në këtë thirrje mund të aplikojnë entitete publike, organizata joqeveritare, OJF/OSHC, subjekte private dhe organizata ndërkombëtare me seli dhe regjistrim në një prej shteteve

anëtare të CEI. Nuk lejohen individë.

- Konsorciumet: Nuk është e detyrueshme të aplikosh si konsorcium, por bashkëpunimi rajonal vlerësohet. Një institucion mund të paraqesë vetëm një aplikim.
- Sipas kësaj thirrjeje, një institucion aplikant mund të aplikojë vetëm një herë.

Aktivitetet e Pranueshme:

- Konferenca, seminare, punëtori, trajnime, evente tematike.
- Aktivitetet duhet të kenë përmbajtje të qartë, ndikim rajonal dhe të kontribuojnë në objektivat e CEI.
- Projektet me komponentë të fortë bashkëpunimi ndërkufitar kanë përparësi.
- Për segmentin 2.2, kërkohet dorëzimi i një Programi Pune (Annex 6).

Cili është buxheti i thirrjes:

Buxheti total i thirrjes: **442,000 EUR**

Segmenti 2.1 – CEI Thematic Agenda: deri në 252,000 EUR

Nga këto, deri në 90,000 EUR për CEI Flagship Events

Segmenti 2.2 – Focused Section: deri në 100,000 EUR

Segmenti 2.1. Axhenda Tematike e CEI-së: aplikantët mund të kërkojnë një kontribut të CEI-së **deri në 15,000 EUR.**

• Segmenti 2.2. Seksioni i Fokusuar: aplikantët mund të kërkojnë një kontribut të CEI-së **deri në 25,000 EUR.**

Kontributi i CEI-së **nuk mund të kalojë 50% të kostos totale të aplikimit.** Aplikimet që kërkojnë një kontribut të CEI-së që tejkalon përqindjen maksimale të përcaktuar më sipër, do të refuzohen automatikisht.

Bashkëfinancimi

Aktivitetet e propozuara duhet të bashkëfinancohen nga burime shtesë përveç CEI-së, të cilat mund të ofrohen në para të gatshme ose në natyrë, qoftë ekskluzivisht ose nga një kombinim i burimeve të parave të gatshme dhe në natyrë. Bashkëfinancimi mund të marrë formën e burimeve të veta të aplikantit (p.sh. personeli, kostot administrative), të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti (p.sh. tarifatat e regjistrimit), kontributeve financiare nga palë të treta/donatorë. Në këtë drejtim, aplikantët do të duhet të përshkruajnë rolin e donatorëve të tjerë (nëse ka) në aktivitetin e propozuar.

Si bëhet aplikimi:

- Dorëzimi online përmes sistemit elektronik të CEI.
- Duhet të bashkëlidhen të gjitha Aneksët e kërkuara në format PDF (maksimumi 2MB për secilin):
 - Buxheti (Excel)
 - Nënshkrimi i aplikuesit (Word)
 - Dëshmia e regjistrimit zyrtar (vetëm për entitete jo publike)
 - Përkthimi në anglisht i dëshmisë së regjistrimit (vetëm për entitete jo publike)
 - Skema e Pjesëmarrjes (Word)
 - Programi i punës (vetëm për Segmentin 2.2)

Kur është afati i fundit:

Aplikimet duhet të dorëzohen në sistem deri më 9 qershor 2025, ora 23:59 (mesnatë) CEST.

Linku i Thirrjes:

<https://application.cei.int/application/cf2025/>